

**STATUTI**  
**I shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar**  
**“Exchange Gjyli” sh.p.k**

Personi qe firmosin me poshte sot me date 24/09/2020

1. **Thoma Gjyli** i datelindjes 15 Maj 1971, lindur ne Debrove Pogradec dhe banues ne Pogradec me adrese Pogradec, Lagjia nr 1 , rruga e korçës Pogradec, person madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i letrnjoftimit me nr 035592299 dhe ID H10515140R.

**I.DISPOZITA TE ORTAKEVE**

Shoqeria “**Exchange Gjyli**” sh.p.k rregullon poziten e saj juridike, marrdheniet e themeluesve, te organeve te saj, llojin e Shoqerise ,kohezgjatjen e veprimtarise se saj,marrdheniet me te punesuarit, duke u baruar ne ligjin Nr. 9901,date14/04/2008”Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare ”dhe dispozitat te legjislacionit shqiptar ne fuqi qe rregullojne marrdheniet e Shoqerive Tregtare

**Neni 1**

**Objekti i veprimtarise**

**Objekti i aktivitetit ekonomik do te jete:**

**Kembim Valutor, transferte parash si dhe ne fushen e dhenies dhe marrjes me qera te pasurive te luajteshme dhe paluajteshme, angjesi imobilare.**

**Neni 2**

Shoqeria eshte person Juridik Privat. Emertimi i shoqerise eshte “**Exchange Gjyli**” shpk. Selia e shoqerise “**Exchange Gjyli**” shpk do te jete ne Rruga “Fan Noli” Lagjia nr 2 Banese Private prane OSHEE, Zona kadastrale 3851 Nr pasurise 4/57 Pogradec.

**NENI 3**

Shoqeria do te kete nje kohezgjatje mbi 10 vjet.Ajo mund te shperbehet ne çdo kohe me vendim te Asamblese se Ortakeve.

**NENI 4**

**Regjistrimi Juridik i Shoqerise**

Shoqeria udhehiqet nga parimet e ekonomise se tergut dhe ka per qellim fitimin.Ajo respekton parimin e reciprocitetit.Ajo eshte nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (Shpk).Veprimtaria e saj i nenshtrohet dispozitave te Aktit se Themelimit,Statutit si dhe dispozitave te legjislacionit tregetar e atij civil ne fuqi.Me vendim te Asamblese se Ortakeve ,Shoqeria mundet qe te ndryshoje regjimin juridik te saj ne perputhje me dispozitave ligjore qe do te jene ne fuqi si dhe ne perputhje te plote me dispozitat te Aktit se Themelimitdhe Statutit te saj ,duke bere edhe pershtatjen e tyre sipas ndryshimeve perkatese.Shoqeria gezon personalitet juridik nga data e regjistrimit te saj ne Regjistrin Tregetar. Shoqeria do te kete vulen e saj.

**NENI 5**

**Kapitali themeltar**





Kapitali themeltar i shoqerise "Exchange Gjyli" shpk do te jete i perbere nga kontributi ne para ne vleren 1.000.000 (Njemilion ) leke. Kapitali themeltar mund te shtohet ose te pakesohet vetem me vendim te Asamblese se Ortakeve te Shoqerise.

Ortaket themelues te shoqerise zoterojne kuotat si me poshte

1- **Thoma Gjyli** 100 % vleres se kapitalit themeltar te Shoqerise te barabarte me 1 kuote me vlere prej 1.000.000 leke.

Kapitali themeltar eshte derdhur teresisht nga ortaku themelues .Vlera dhe deklarimi i kapitalit themeltar do te kryhet ne momentin e nenshkrimt.

#### **NENI 6**

##### **Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit**

Me vendim te asamblese se ortakve mund te zmadhohe dhe te pakesohet kapitali themeltar, ne perputhje me ligjin e shoqerive tregtare, neni 81.

Zmadhimi i kapitalit themeltar mund te vendoset kur e kerkojne interesat e Shoqerise duke vendosur kuotat suplementare te Ortakeve. Zvogelimi i kapitalit nuk duhet te demtoje kreditorët e saj te krijoje pasiguri tek ata qe kane dhene kerdi para publikimit te zvogelimit te kapitalit .Ne te kunderten Gjykata e konsideron te pavleshme kete vendim mbi kerkesen e kreditorëve.

#### **NENI 7**

##### **Financimet e Ortakeve**

Ortaket mund te kryejne financime ne favor te shoqerise me kundershperblim ose jo, me ose pa detyrimin e rimbuesimit ,ne baze te nje vendimi nga ortakët.

#### **NENI 8**

##### **Abuzimi i ortakëve ndaj shoqerise**

Ortakët ,e shoqerise tregtare ,qe kryejne nje apo me shume nga veprimet ose mosveprimet vijuese, pergjigjen personalisht e ne menyre solidare per detyrimet e shoqerise ,me te gjithe pasurine e tyre nese:

- a. Abuzojne me formen e shoqerise tregtare per arritjen e qellimeve te paligjshme;
- b. Trajtojne pasurite e shoqerise tregtare si te ishin pasurite e tyre;
- c. Ne castin kur kane marre apo kishin marre djeni per gjendjen e paaftesise paguese te shoqerise ,nuk marrin masat e nevojshme ,per te siguruar qe shoqeria ,ne varesi te llojit te veprimtarise se ushtruar ,te kete kapitale te mjaftueshme ,per te permbushur detyrimet e marra persiper ndaj paleve te treta.

#### **NENI 9**

##### **Ndalimi i konkurrencës**

Ortakët nuk mund te mbajne nje pozicion drejtues apo te jene te punesuar ne shoqeri te tjera ,qe ushtrojne veprimtari ne te njejtin sektor ekonomik me shoqerine. Gjithashtu ,ata nuk mund te mbajne statusin e targetarit per te ushtruar veprimtari ne kete sektor. Statuti mund te parashikojë qe ndalimi i permendur me siper te shfuqizohet nepermjet nje autorizimi te posacem, te dhene nga ortakët ,apo nga asambleja e ortakëve me 51% votave. Ky autorizim mbetet ne fuqi edhe pas humbjes se cilesive qpo statutit te permendur ne te ,por jo per nje periudhe me te gjate se nje vit pas humbjes se kesaj cilesie.

Nese ndonjeri perj ortakëve shkel ndalimin e konkurrencës, shoqeria mund :

- a. Ta perjashtojë ate nga shoqeria e veprimtarise konkurruese



- b. Te kerkoje nderprerjen e veprimtarise konkurruese
  - c. Te ngreje padi per shperbimin e demit.
- Shoqeria ,si alternative te ngritjes se padise per shperblimin e demit ,mund t'i kerkoje secilit perj ortakeve:
- a. Te pranoje se transaksionet e kryera per llogari te tij te kalohen per llogari te shoqerise.
  - b. T'i trasferoje shoqerise te gjitha perfitimet qe ka marre nga kryerja e veprimtarise per llogari te personave te trete
  - c. T'i trasferoje shoqerise te gjitha te drejtat e kerdise, qe kane rrjedhur nga kryerja e veprimeve per llogari te personave te trete.

#### **NENI 10**

##### **Pronesia mbi kuotat**

Kuotat e kapitalit dhe te drejtat qe rrjedhin prej tyre fitohen ose kalohen ,nepermjet :

- kontributit ne kapitalin e shoqoise
- shit-blerjes
- trashegimise
- dhurimit
- ne cdo menyre tjeter te parashikuar ne ligj.

#### **NENI 11**

##### **Trasferimi i kutave nepermjet te gjalleve**

Ortaket e shoqerise ne rastet e trasferimit te kutave rezervojne te drejten e parablerjes se kutave te kapitalit te shoqerise.

Ne nje rast te tille kur ortaku kerkon te shese kuoten ose pjese te saj ,duhet te njoftoje prane organit administrativ dhe tek ortaket e tjere, nepermjet nje letre rekomande duke specifikuar cmimin dhe modalitetet e pageses.

Brenda 30 diteve nga ky komunikim, ortaket e tjere duhet te lajmerojne nepermjet nje letre rekomande nese duan ta ushtrojne te drejten e parablerjes.

Kur afati 30ditor kalon pa anje lajmerim nga ortaket ,atehre e drejta e parablerjes do te konsiderohet e ezauruar.Ne nje rast te tille trasferimi tek te tretet do te kryhet nepermjet pelqimit te Asamblese se Ortakeve ,e cila duhet te shperhet brenda 30 dite nga marrja e kerkeses.

#### **NENI 12**

##### **Vdekja e Ortakut**

Trasferimi i kuotes ne rastin e vdekjes se nje ortaku,si ne menyre te vecante dhe ne menyre universale,do te kryet sipas menyres se meposhtme:

-shoqeria do te vazhdoje te kryeje aktivitetin e saj me nje apo gjithe trashegimtarit e te ndjerit

-per percaktimin e vleres se kuotes se ortakut te vdekur e cila i takon trashegimtarit te te ndjerit,ne rast te likuidimit aplikohet neni 15 me poshte.

#### **NENI 13**

##### **Largimi nga shoqeria dhe likuidimi i kuotes**

Ortaku mund te largohet nga shoqeria nese ortaket e tjere ose shoqeria kane kryer veprime ne dem te tij,nes eshte penguar te ushtroje te drejtat e tij, nese shoqeria i ka ngarkuar detyrime te paarsyeshme apo per shkaqe te tjera , qe e bejne te pamundur





vazhdimin e ortakrise. Ortaku qe kerkon largimin, duhet te njoftoje shoqerine me shkrim ,si dhe te parashtroje shkaqet e largimit .Administratoret duhet te therrasin mbledhjen e asamblese se ortakeve menjehere pasi te kene marre dijeni per njoftimin e largimit ,per te vendosur nese ortakut do t'i likuidohet kuota,si pasoje e largimit per shkaqe te arsyeshme.Ortaku ka te drejte te ngreje padi ne gjykate ndaj shoqerise per likudimin e kuotes,si pasoje e largimit per shkaqe te arsyeshme ,nese pas njoftimit te largimit asambleja e ortakeve nuk mblidhet apo nuk i njej si te arsyeshme shkaqet e largimit dhe likudimin e kuotes.Ortaku qe kerkon largimin nga shoqeria, detyrohet ta demshperbeje shoqerine per demet e shkaktuara ,nese rezulton se largimi eshte kryer ne baze te shkaqeve te paarsyeshme. Ortaku ka te drejte te ngreje padi ndaj shoqerise dhe /ose ortakeve te tjere qe shkaktuan largimin e tij dhe te kerkoje ndaj tyre, ne menyre solidare ,shperblimin e demit te pesuar.

#### **NENI 14**

##### **Perjashtimi i ortakut**

Ne baze te nje vendimi te asambleja e ortakeve mund t'i kerkoje gjykates perjashtimin e ortakut,nese ai nuk ka shlyer kontributin e tij ,sipas parashikimeve te statutit ose nese ekzistojne shkaqe te tjera te arsyeshme per kete perjashtim.Konsiderohen shkaqe te arsyeshme per perjashtimin e ortakut,por pa u kufizuar ne to, rastet kur ortakut:

- Me dashje apo me pakujdesi te rende i shkakton deme shoqerise ose ortakeve te tjere.
- Me dashje apo me pakujdesi te rende shkel statutin ose detyrimet e percaktuara me ligj.
- Perfshihet ne veprime ,te cilat e bejne te pamundur vazhdimin e marredhenieve midis shoqerise tregtare dhe ortakut
- Me veprimet e tij demton ose pengon ndjeshem veprimtarine tregtare te shoqerise.

Gjate procedures se perjashtimit te ortakut , me kerkese te paditesit, gjykata mund te marre nje mase per sigurimin e padise, duke pezulluar te drejten e votes se ortakut, qe kerkohet te perjashtohet, si dhe te drejta e tjera, qe rrjedhin nga zoterimi i kuotes se shoqerise, kur ajo e vlereson kete mase si te nevojshme dhe te justifikuar.Shoqeria ka te drejte t'i kerkoje ortakut te perjashtuar shperblimin e demit te pesura nga veprimet ,qe kane sjelle perjashtimin.Ortaku ka te drejte t'i kerkoje shoqerise shperblimin e demit te pesuar ,nese kerkesa per perjashtim nuk eshte e bazuar.Ortaku nuk ka te drejte t'i kerkoje shoqerise likudimin e kuotes ,nese ai perjashtohet per shkaqe te arsyeshme ,por nese shoqeria ngre padi ndaj tij padi per shperblim demi,ortaku ka te drejte te kompesoje cdo shume, qe do te kishte te drejte ta perfitonte ne cilesine e likuidimit te kuotes,me demin e kerkuar nga shoqeria.

#### **NENI 15**

##### **Likudimi i kuotes**

Ne rastet e parashikuara me siper ne nenet 12,13 dhe 14,kuota do t'i likudohet ortakut qe largohet apo qe perjashtohet,apo trashegimtareve te ortakut te vdekur ne perpjestim me paurine e shoqerise. Pasuria e shoqerise do te percaktohet nga nje raport i organit administrativ duke marre njekohesisht dhe mendimin e nje eksperti kontabel ne rastse shoqeria ka te tille,duke patur parasysh vleren e tregut te kuotave te zoteruara ne ditën e



vdekjes se ortakut apo ne diten e marrjes se vendimit sipas ligjit per largimin apo perjashtimin e ortakut. Likudimi i kuotave te zoteruara duhet te realizohet brenda 180 diteve nga dita ne te cilen eshte vendosur likudimi. Likudimi mund te behet nepermjet blerjes se kuotave nga ana e ortakëve qe mbeten ne propocion me pjesen e zoteruar perj tyre ose me shitjen e kuotave tek nje person i trete, i cili eshte miratuar nga ortakët e tjere. Ne rast se kjo nuk arrihet ,atehere likudimi do te behet nepermjet perdorimit te rezervave ekzistuese te shoqerise ose nepermjet zvogelimit te kapitalit ne prppocion me masen e kuotave qe duhet te likudohet, me perjashtim te rastit kur zvogelimi vjen ne kundershtrim me ligjin.

## NENI 16

### Adminstrimi dhe perfaqesimi

Shoqeria mund te administrohet ner menyre te alternuar, me vendim te ortakëve sipas emerimit nga

1. Administratori i vetem

2. Nga dy apo me shume administratore me kopetenca te perbashketa ose te vecanta.

Ne rast se adminstratoret emerohen pa ju referuar ndonje rregulli per ushtimin e kopetencave te administratoreve, do i behet referim rregullave te ortakëve te ligjit 9901, date 14.04.2008. Adminstratoret mund te jene dhe jo ortakë. Nuk mund te emerohen administratore dhe ne rast se jane emeruar shkarkohen ,ata qe jane subjekt i neneve 13 dhe 95 te ligjit 9901, date 14.04.2008. Afati i emerimit ,nuk mund te jete me gjate se 5 vjet, me te drejte riperteritje. Emerimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit. Statuti mund te vendose rregulla te posacme per emerimin e administratoreve. Administratorët do te perfitojne nje shperblimte miratuar nga ortakët, do te kene te drejten e rimburesimit te shpenzimeve te kryera per arsye pune, si dhe do te perfitojne nje shperbilim ne rastin kur largohen nga detyra. Asambleja e ortakëve mund te emeroje perfaqesues te posacem per pune te vecanta apo grup punesh dhe ti revokojë ata, mund te emeroje drejtore ,zv. drejtore dhe agjente ,mund te ndermarre dhe perballet me ceshtje gjyqesore ne cdo shkalle gjyqesore duke emeruar avokate, perfaqesues dhe eksperte dhe duke i revokuar ata.

Admistratori i shoqerise "Exchange Gjyli" shpk do te jete: **Kledi Gjyli** me afat 5 vjet nga data 24/09/2020 deri ne date 23/09/2025, me adrese Pogradec, Lagjia nr 1 Zona Industriale Pogradec, person madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, e datelindjes 01/02/1995, mbajtese Kartes se Identitetit me nr 031666828 dhe ID J50201096V.

## NENI 17

### Te drejtat dhe detyrimet e administratoreve

Admistratorika te drejte e detyrohet te:

1. kryeje te gjitha veprimet tregetare te shoqeise, duke zbatuar politikat tregetare, te vendosura nga asambleja e ortakëve,
2. perfaqesojë shoqerine tregetare
3. kujdesen per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumentave dhe librave kontabel te shoqerise





4. pergatisin dhe nenshkruajne bilancin vjetor, bilacin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe ,se bashku me prpozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqesin keto dokumente perpara asamblese se ortakeve per miratim,
5. krijojne nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise.
6. Kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqerise, sic parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit,
7. Rapotojne perpara asamblese se ortakeve ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregtare,
8. Kryejne detyra te tjera te percaktura ne ligj dhe ne statut,
9. Te therrasin asamblen e ortakeve kur shoqeria brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane vlere me te larte se 5% te aseteteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara dhe kur sipas bilancit vjetor apo raporteve te nermjetme financiare ,rezulton ose egziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.

Asambleja e ortakeve mund te shkarkoje administratorin ne cdo kohe me shumice te zakonshme .Statuti apo marrveshje te tjera nuk mund te perjashtojne apo kufizojne kete te drejte.Padite, qe lidhen me shperblimin e administratorit , ne baze te marrdhenieve kontraktore me shoqerine , rregullohen sipas dispozitave ligjore ne fuqi.Administratoret do te kene te drejte te bejne drejtimin e zakonshem dhe teknik apo administrativ por me firme te perbashket , ne rastin e blerjeve ose te kredive apo per veprime te tjera administravive te cilat ka nr nje vlere me te madhe se 5000 euro.

#### **NENI 18**

##### **Asambleja e ortakeve**

Te gjitha vendimet e shoqerise merren nga ortaket ne perputhje me dispozitat e percaktuar ne ligjin "Per shoqerite tregtare" ne lidhje me marrjen e vendimeve ne asamblese.


Asambleja e ortakeve eshte organi me i larte vendimarres

Asambleja e ortakeve ka keto te drejta dhe detyrime

- Miraton planin dhe programin e zhvillimit dhe aktet e ortakeve te shoqerise.
- Merr vendime per ndryshimin e formes, selise, emertimit, kapitalit, veprimtarise se shoqerise, ndryshimin ne zoterimin e kuotave te kapitalit te shoqerise, te largimi dhe pranimit te ortakeve, pjesemarres se shoqerise ne shoqeri te tjera e anasjelltas.
- Miraton raportet financiare dhe bilancin vjetor, vendos per perdorimin e fitimit,organizimin e shoqerise dhe prishjes se saj.
- Emeron dhe shkarkon Administratorin e pergjithshem, administratorin, likujdatorin, ekspertin dhe ekspertet kontabel si dhe drejton veprimtarine e rendesishme te shoqerise.
- 

#### **NENI 19**

##### **Thirrja e asamblese se ortakeve**





Mbledhja e Asamblese se Ortakeve realizohet nepermjet njoftimit me poste elektronike, leter rekomande te ortakeve nga administratori i shoqerise jo me vone se 7-dite perpara duke u njoftuar per daten e mbledhjes, vendin, oren, rendin e dites. Kur asambleja e ortakeve nuk eshte thirrur si me sipër, ajo mund te marre vendime te vlefshme nese te gjithë ortaket jane dakord, per te marre vendime, pavaresisht parregullsive.

#### **NENI 20**

##### **Kuorumi i nevojshem dhe vendim-marrja**

Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojn e nje shumice te zakonshme, asambleja e ortakeve mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30% te kapitalit. Ne rastet kur kerkohet shumica e kualifikuar, asambleja e ortakeve mund te marre vendime te vlefshme vetem nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese ose mejete elektronike. Nese asambleja e ortakeve nuk mblidhet dot per shkat te mungeses se kuorumit te permendur mesiper, ajo mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te nejte rend dite.

Çdo ortak merr pjese ne marrjen e vendimeve duke disponuar nje numer votash te barabarte me pjeset e kapitalit qe ai zoteron. Marrja e vendime merrte me shumicen e votave per çdo rast, sipas ligjit ne fuqi.

#### **NENI 21**

##### **Procesverbali i mbledhjes se asamblese**

Te gjitha vendimet e asamblese se ortakeve duhet te regjistrohen ne procesverbal. Administratorët pergjigjen per ruajtjen e kopjeve te procesverbaleve te mbledhjeve te asamblese se ortakeve.

Procesverbali duhet te permbaje daten e vendin e mbledhjes, rendin e dites, emrin e kryetarit e te mbajtesit te procesverbalit, rezultatet e votimit. Procesverbali i bashkalidhet edhe lista e pjesmarresve, si dhe akti i thirrjes se asamblese se ortakeve. Procesverbali i mbledhjes nenshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtesi i procesverbalit.

#### **NENI 22**

##### **Hetimet e posacme**

Asambleja e ortakeve mund te vendose nisjen e nje hetimi te posacem per parregullsite pergjate veprimeve te themelimit te shoqerise apo te ushtrimit te veprimtarise tregtare. Hetimi kryhet nga nje ekspert i pavarur i fushes. Ortaket qe perfaqesojne te pakten 5% te totalit te votave ne asamblene e shoqerise, apo nje vlere me te vogel te parashikuar ne statut dhe/ose cilido kreditor i shoqerise mund t'i kerkojne asamblese se ortakeve emerimin e nje eksperti te pavarur te fushes, kur ka dyshime te bazuara per shkelje ligji ose te statutit ne te kunder brenda 30 diteve pas refuzimit nga asambleja e ortakeve per emerimin e ekspertit te pavarur, mund t'i kerkojne gjykates emerimin e ketij eksperti. Nese asambleja e ortakeve nuk merr nje vendim brenda 60 diteve nga data e paraqitjes se kerkeses, kerkesa e ortakeve vleresohet e refuzuar.

E drejta per te kerkuar hetim te posacem, duhet te ushtrohet brenda 3 vjeteve nga data e refjistrimit te shoqerise tregtare, kur hetimi ka si objekt parregullsite e procesit te themelimit, si dhe brenda 3 vjeteve nga data e veprimit kur objekt eshte parregullsite e ushtrimit te veprimtarise tregtare.



### **NENI 23**

#### **Perdorimi i te ardhurave neto**

E ardhura neto qe rezulton mbasi zbriten shpenzimet e bera per kryerjen e cdo lloj aktiviteti nga zbritja e vleres se amortizimit,nga tatimet dhe taksat, nga kuotat qe rritin kredine per investime,paga e shperblimet ,perdoret nga ortaket,sipas qellimeve te tyre.

### **NENI 24**

#### **Bilanci dhe plani financiar**

Pasuria e Shoqerise vleresohet ne bilancet e saj ne monedhe te vendit ose ne monedhe te huaj sipas vleresimit te ortakeve ose eksperteve ne momentin e Themelimit te shoqerise.Bilanci vjetor duhet te paraqitet brenda afateve te vendosura nga legjislacioni ne fuqi. Forma e bilacit percaktohet nga administratori ne harmoni me format e bilanceve te vendosura ne Republikene Shqiperise.

Plani financiar parashikon aktivin e pasivin e aktivitetit ekonomik te Shoqerise ,te shprehur ne leke ose valute te konvertueshme.Llogaria ekonomike do te mbahet ne Shqiperi.

### **NENI 25**

#### **Shperndarja e fitimeve**

Ortaket kane te drejte te ndajne pjesen e fitimit te deklaruar ne pasqyrat financiarete shoqerise.Fitimi u shperndahet ortakeve ne raport me kuotat e zoteruara.

### **NENI 26**

#### **Kufizimi i shperndarjeve te fitimeve**

Shoqeria mund t'u shperndaje fitime ortakeve, vetem pas pagimit te dividendit:


- a) Aktivet e shoqerise mbulojne tersisht detyrimet e saj
- b) Shoqeria ka aktive likuide te mjaftueshme per te shlyer detyrimet qe behen te kerkueshme brenda 12 muajve ne vazhdim

Administratoret leshojne certificate te aftesise paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shperndarja e propozuar e dividenteve permbush kerkesat e mesiperme.Kur gjendja e shoqerise tregon se shperndarja e propozuar e dividenteve nuk i permbush keto kriteret, adfministratoret nuk mund ta leshojne kete certificate.Administratoret pergjigjen ndaj shoqerise per vertetesine e certificate se aftesise paguese.Administratoret , te cilet nga pakujdesia leshojne nje certificate te pasakte te aftesise paguese,pergjigjen personalisht perpara shoqerise per kethimin e dividenteve te shperndare.Ortaket ,qe kane marre nga shoqeria dividende,pergjigjen personalisht ndaj shoqerise per kethimin e dividendeve, qe u jane shperndare kur nuk eshte leshuar certificate e aftesise paguese,ose kur, pavaresisht leshimit te certificate, keta ortaket kane pasur djene per gjendjen e paafesise paguese te shoqerise,ose ne baze te rrethanave te qarta nuk mund te mos kishin pasur djene per kete gjendje.

### **NENI 27**

#### **Eksperti Kontabel**

Shoqeria cakton ekspert kontabel per cdo vit financiar kur jemi perpara rasteve te percaktuara ne ligj.Emerimin e tyre e ben Mbledhja e Asamblese se ortaveve.Ekspertet kontabel mbajne pergjegjesi per mbajtjen e rregullt te te gjitha dokumentacioneve te shoqerise.Ata pergjigjen per demet qe i vijne shoqerise nga mbajtja e pa rregullt e





Ilogarive ose verifikimi i tyre i gabuar. Nuk mund te ngarkohen me detyren e ekspertit, themeluesi, administratori, personat qe jane gjini e krushqi me ata deri ne shkallen e kater.

#### **NENI 28**

##### **Marrdheniet e punes**

Marrdheniet e punes ne shoqeri rregullohen sipas dispozitave te Aktit te Themelimit ,Statutit dhe Legjislacionit Shqiptar te Punes.

Punesimi ne shoqeri realizohet me ane te kontrates individuale te punes midis shoqerise e te punesuarve. Marrdheniet midis shoqerise e sindikates rregullohen nepermjet kontrates kolektive te punes.

#### **NENI 29**

Te punesuarit dhe punonjesit drejtues administrativ jane pergjegjes per demet qe i shkaktojne shoqerise per faj te tyre dhe pergjigjen para asj civilisht.

#### **PRISHJA E SHOQERISE. LIKUJDIMI.**

#### **NENI 30**

Kjo shoqeri do te priset ne rast kur:

1. Merr vendim Asambleja e ortakeve
2. Hapen procedurat e falimentimit
3. Nuk ka kryer veprimtari tregetare per dy vjet nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimzarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr.9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Biznesit "
4. Merret nje vendim gjykate
5. Per arsye te tjera , te parashikuara ne statut.

Prishja e shoqerise regjistrohet ne Regjistrin tregetare te QKB

#### **NENI 31**

##### **Likudimi i shoqerise**

Prishja e shoqerise tregetare ka si pasoje hapjen e procedurave te likudimit ne gjendjen e aftesise paguese , me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi. Likujdimi i shoqerise behet me Vendim te Asamblese se Ortakeve, sipas rasteve te parashikuara ne ligjin 9901, date 14.04.2008. Nese asambleja nuk merr nje vendim per emerimin e likuidueseve ,brenda 30 diteve pas prishjes, cdo person i interesur mund t'i drejtohet gjykates, per te caktuar nje likuidues.

#### **NENI 32**

##### **Te drejtat e detyrimet e likuiduesit**

Detyra e likuiduesve eshte mbyllja e te gjitha veprimeve te shoqerise ,mbledhja e kredive te paarketuara dhe e kontributeve te pashlyera, shitja e pasurive te shoqerise dhe shlyerja e kreditorve duke respektuar radhen e referimit ,sipas nenit 605te Kodit Civil. Likuiduesi mund te kryeje edhe veprime te reja tregetare, per mbylljen e nje veprimi te paperfunduar. Nese shoqeria nuk ka pasuri qe te shlyeje te gjitha kontributet e pashlyera atehere likuidusi i kerkon gjykates per nisjen e procedurave te falimentimit.

#### **NENI 33**

##### **Bilancet e likudimit**

Likuiduesi pergatit nje bilac te gjendjes se shoqerise ne castin e hapjes se likudimit dhe nje bilanc perfundimtar ne castin e mbylljes se ketyre procedurave. Nese likuidimi zgjat me shume se nje vit likuiduesi pergatit dhe pasqyrat financiare. Bilacet miratohen nga asambleja e ortakeve.



#### **NENI 34**

##### **Shperndarja e aktiveve**

Pas shlyerjes se detyrimeve ndaj kreditorëve, likuiduesi u shperndan ortakeve apo aksionerve aktivet e mbetura, sipas te drejtave qe ata kan ene ndarjen e fitimeve. Pasurite ,qe i jane dhene shoqerise me qira apo per perdorim ju kethehen ortakeve. Pasi jane bere keto veprime likuiduesi njofton QKB per perfundimin e likuidimit dhe kerkon cregjistrimin e shoqerise.

#### **NENI 35**

##### **Likuidimi i thjeshtezuar**

Kur shoqeria likuidohet nga nje procedure e pershpejtuar dhe te gjitha detyrimet jane shlyer atehere administratori ne perputhje me nenin 43 te ligjit nr.9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" njofton QKR vendimin per likudimin e shoqerise ,nepermjet procedures se thjeshtezuar. Administratoret jane pergjegjes per demin e shkaktuar nga shkelja e detyrave te tyre gjate likudimit te thjeshtezuar.

##### **DISPOZITA TE FUNDIT**

#### **NENI 36**

Ky statut hyn ne fuqi pas miratimit dhe regjistrimit te Shoqerise ne regjistrin tregetar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit.

#### **NENI 37**

Gjithcka nuk eshte parashikuar shprehimisht ne kete Statut do te disiplinohet nga legjislacioni tregetar dhe ligje te tjera lidhur me te ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.

#### **NENI 38**

Ky statut eshte hartuar ne 4 (kater) ekzemplare origjinale duke patur fuqi te barabarte ligjore.

### **SHOQERIA ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

***"Exchange Gjyli"* shpk**

**ORTAKET THEMELUES**

**Thoma Gjyli**

